



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:005642
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05635682

PA1.nr.1081/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ilmije Rexhepi Beqiri si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit G.M, për shkak të veprës penale, Kanosja nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK, duke vendosur përkritazi me ankesën e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, P.nr.25/2022 të dt.13.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 24.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.25/2022 të dt.13.07.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, me aktgjykimin P.nr.25/2022 të dt.13.07.2023, të akuzuarin G.M e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale, Kanosja nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK, dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve. Në kuptim të nenit 44 të KPK-së, me propozimin e të akuzuarit, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej njëmijë e dyqind (1.200,00) euro, ashtu që i akuzuari është i obliguar që dënimin me gjobë ta paguaj në katër këste mujore, duke filluar prej secilit këst nga çdo fillim i muajit 01-05 të muajit vijues, në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj

dënimin me gjobë, gjykata mund ta zëvendësoj ashtu që për çdo 20 euro do ti caktohet 1 (një) ditë burgim, gjithsej 60 ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit duhet të paguajë shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat ligjor prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohen në kontest të rregullt civilo-juridik.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal nga neni 187 par. 1 të KPRK-së, me propozim që gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar lidhur me vendimin mbi dënimin, në atë mënyrë që të akuzuarit G.M t'i shqiptoj dënim me burgim efektiv, me të cilin dënim do të arrihet në mënyrë të plotë qëllimi i dënimit.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1117/2023 të datës 06.09.2023, ka propozuar që të aprovet ankesa Prokurorit i Prokurorisë Themelore në Prishtinë ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim efektiv, me të cilin dënim do të arrihet në mënyrë të plotë qëllimi i dënimit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është atakuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj dhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarës e të cilat do të kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me pretendimet se gjykata e gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me këtë çështje penale me rastin kur ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtin e ka shpallur fajtor, por nuk e ka caktuar drejt lartësinë e dënimit, duke mos i vlerësuar dhe peshuar drejt të gjitha rrethanat, si ato rënduese ashtu edhe ato lehtësuese me rastin e matjes së dënimit. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar në mënyrë të drejtë rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat edhe i ka listuar një nga një kjo gjykatë, mirëpo gjykata i ka mbi vlerësuar vetëm rrethanat lehtësuese dhe atë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin për rastin e ndodhur, kërkim faljen dhe premtimin se nuk do të përsërisë veprime të tilla kundërligjore duke i mos i marr parasysh rrethana rënduese të cilat edhe i ka cekur si:

shkallen e lartë të dashjes, faktin se vepra penale është kryer me paramendim, shkalla e lartë e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, mënyra e kryerjes së veprës penale, përgjegjësia penale, pastaj peshën e veprës penale sepse kemi të bëjmë me vepra penale në kuadër të veprave penale të Dhunës në familje, të pikërisht ndaj anëtareve të familjes po ashtu duke pasur parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, kur dihet fakti se veprat penale të kësaj natyre janë në rritje në territorin e Republikës së Kosovës dhe se viktimat e ndjeshme si në rastin konkret (të dhunës në familje) mbrohen edhe me Ligjin e veçantë — Ligjin nr.03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje si dhe duke pas parasysh intensitetin e vlerës së mbrojtur (jetën dhe trupin), konsideroj se gjykata po ti kishte peshuar të gjitha këto rrethana rënduese tek matja e dënimit, me siguri se do të kishte shqiptuar një dënim me burgim efektiv, krejt kjo në drejtim edhe të zbatimit të politikës ndëshkimore, andaj edhe konsiderojmë se dënimi i shqiptuar nga gjykata nuk i përgjigjet rastit konkret dhe me dënimin e këtillë të shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së. Gjykata po ta kishte zbatuar udhëzuesin për politikën ndëshkimore, me siguri që të akuzuarit do t'i shqiptonte dënim me burgim efektiv.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të ulët për të akuzuarin. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit në pajtim me dispozitat e nenit 69 të KPK-së, pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori parasysh faktin se i akuzuari pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin për rastin e ndodhur, kërkim faljen dhe i pretoj gjykatës se nuk do të përsëris veprime të tilla kundërligjore, ndërsa si rrethana rënduese ka marr për bazë shkallën e lartë të dashjes, pasi që i akuzuari e kanos me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose do ti shkaktojë lëndime të rënda të dëmtuarës ish-bashkëshortes së tij, duke kërkuar që e njëjta ta hap derën për të hy brenda dhe e kanos me fjalë “qiti fëmijët jashtë se do të hy brenda, mos dil jashtë se unë të prej”, pra vepra penale është kryer me paramendim, shkalla e lartë e rrezikimit të vlerave të mbrojtura,

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e prokurorit për ti shqiptuar një dënim më të lart konsideron se janë të pabazuara. Ngase të gjitha këto rrethana, e sidomos duke marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin për rastin e ndodhur, kërkim faljen dhe premtimin gjykatës se nuk do të përsëris veprime të tilla kundërligjore, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësive penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës

gjeneralë, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1081/2023, më datë 24.04.2024

Procesmbajtësja,
Ilmije Rexhepi Beqiri

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Abdullah Ahmeti

Zyhdi Haziri
